



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2021:232375
Datë: 05.08.2024
Numri i dokumentit: 06016161

C.nr.1535/21

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Blerina KURTAJ në çështjen juridike kontestimore të paditësit A. J. nga fsh. Babaj i Bokës, komuna Gjakovë, të cilin me autorizim e përfaqëson Bardh Maksuti, avokat me seli në Gjakovë, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve ”S.”, me seli në Prishtinë, me objekt kontesti kompenzim dëmi vlera e objektit të kontestit 4,300.00 Euro, në seancën përgatitore të datës 09 Gusht 2024, mori dhe përpiloi këtë:

A K T V E N D I M

I. KONSIDEROHET e tërhequr padia e paditësit A. J. nga fsh. . . , komuna Gjakovë, të cilin me autorizim e përfaqëson Bardh Maksuti, avokat me seli në Gjakovë, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve ”S.”, me seli në Prishtinë, me objekt kontesti kompenzim dëmi.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi, përmes të autorizuarit të tij, në këtë gjykatë me datë 08.11.2019, kanë paraqitur padi kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve ”S.”, me seli në Prishtinë, me objekt kontesti kompenzim dëmi.

Gjykata lidhur me këtë çështje kontestimore ka caktuar seancën përgatitore me datë 05.08.2024, në të cilën seancë nuk ka prezantuar paditësi, edhe pse ka qenë e ftuar në mënyrë të rregullt,

ashtu siç vërtetohet nga procesverbali i seancës së datës 15.07.2024, dhe mungesën për këtë seancë nuk e ka arsyetuar në asnjë mënyrë.

Gjykata në mbështetje të nenit 409, par.1 të LPK-së, ku është përcaktuar se: *“Në qoftë se në seancën përgatitore nuk vjen pala paditëse, edhe pse është thirrur rregullisht, padia konsiderohet e tërhequr, përveç kur i padituri kërkon që seanca të mbahet”*, dhe duke marrë parasysh se në rastin konkret paditësit kanë qenë të ftuar në mënyrë të rregullt dhe mungesën për seancë nuk e kanë arsyetuar, erdhi në përfundim se padia e paditësit duhet të konsiderohet e tërhequr në këtë çështje kontestimore.

Vendimin rreth shpenzimeve procedurale gjykata e mori në mbështetje të nenit 450 dhe 463.1 dhe 4 e LPK-së.

Nga të lartcekurat dhe në mbështetje të nenit 409, pika 1 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.1535/21, me 05 Gusht 2024.

Gj y q t a r j a

Blerina KURTAJ

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi është lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve, pas marrjes së të njëjtit në Gjykatën e Apelit, nëpërmjet kësaj Gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.